



**BASHKITË PËR NË EVROPË**  
Një projekt i financuar nga BE

**MANUAL INFORMUES  
PËR ROLIN E QEVERISJES  
LOKALE NË PROÇESIN  
E INTEGRIMIT EVROPIAN  
TË SHQIPËRISË**

Prill 2018





## **MANUAL INFORMUES PËR ROLIN E QEVERISJES LOKALE NË PROÇESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN TË SHQIPËRISË**

Ky botim është mundësuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e projektit “Bashkitë për në Evropë” dhe në asnjë mënyre nuk mund të interpretohet si opinion i Bashkimit Evropian.

Prill 2018



HYRJE .....	7
ÇFARË ËSHTË BE? .....	9
PARLAMENTI EVROPIAN .....	13
KOMISIONI EVROPIAN .....	14
KËSHILLI I BE-SË .....	15
KËSHILLI EVROPIAN .....	16
BE DHE PUSHTETI VENDOR .....	17
KIR DHE ZGJERIMI I BE .....	20
BE-JA DHE SHQIPËRIA .....	22
FUSHAT PRIORITARE PËR PUSHTETIN VENDOR .....	31
MBROJTJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT .....	39
POLITIKA MJEDISORE .....	48
POLITIKA TE KOHEZIONIT .....	57



# HYRJE

Për më shumë se një dekadë Shqipëria ka hyrë në rrugën e pakthyeshme të integritimit Evropian. Procesi i integritimit mbështetet në reformat e marra nga shteti shqiptar që kërkojnë përfshirjen e të gjithë aktorëve të shoqërisë. Pushteti vendor ndonëse nuk është një nga aktorët kryesor në menaxhimin e këtij procesi, përsëri ai është i ndikuar prej tij si në organizim ashtu edhe në funksionim. Si një nga hallkat e pushtetit ai duhet t'i përshtatet ndryshimeve dhe dinamikës që kërkojnë proceset integruese duke sjellë me pranë qytetarëve përfitimet e këtij procesi.

Projekti “Bashkitë për në Evropë”, si një iniciativë e përbashkët e institucioneve shqiptare dhe Bashkimit Evropian, synon pikërisht ndërgjegjësimin dhe forcimin e rolit të pushtetit vendor në procesin e integritimit Evropian. Pjesë e aktiviteteve të këtij projekti është dhe përgatitja e këtij manuali informues. Manuali shpjegon në vija të përgjithshme funksionimin e Bashkimit Evropian dhe procesin e integritimit të Shqipërisë, ndërkohë që një vend të posaçëm zë shpjegimi i rolit të pushtetit vendor në BE dhe në zbatimin e standardeve Evropiane. Vënia në dukje e këtij roli orienton pushtetin vendor në Shqipëri për sfidat e të sotmes dhe të ardhmes. Manuali nuk bën analiza shteruese, por ai tregon përmbajtjen e politikave Evropiane dhe detyrimet që burojnë për Shqipërinë duke sjellë të dhënat të përgjithshme për këto fusha.





# ÇFARË ËSHTË

# BE?

Historia e Bashkimit Evropian (BE1) e ka zanafillën pas Luftës së Dytë Botërore, atëherë kur 6 shtete të Europës, përkatësisht Gjermania, Franca, Italia, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu themeluan Komunitetet Evropiane me qëllim që nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit ekonomik të promovonin paqen dhe prosperitetin në kontinent. Sot, në 2018 Bashkimi Evropian numëron 28/27 shtete anëtare dhe një sërë arritjesh duke sjellë atë më pranë një bashkimi politiko-ekonomik sesa kurrë më parë. I konsideruar si një organizëm politik sui generis, ai është zhvilluar në shumë drejtime duke përfshirë të gjitha politikat publike dhe duke krijuar një lidhje më të afërt me qytetarët Evropianë.

---

1\* - Për më shumë infomacion referoju faqes zyrtare të BE-së:

[https://europa.eu/european-union/about-eu\\_en](https://europa.eu/european-union/about-eu_en)

## Arritje

- Mbi 50 milion banorë
- Kontribues i paqes dhe prosperitetit ekonomik dhe social
- Tregu i vetëm me i madh në botë
- Fuqia më e madhe tregtare dhe humanitare

## Të drejtat që burojnë nga Qytetaria Evropiane:

- E drejta e votës në Parlamentin Evropian;
- E drejta e votës për zgjedhjet me qeverisjen vendore të një vendi tjetër;
- E drejta për transparencë ndaj institutioneve;
- E drejta për të komunikuar në gjuhën amtare;
- E drejta për të lëvizur dhe qëndruar;
- E drejta për të mos u diskriminuar;
- E drejta për mbrojtje diplomatike konsullore në një vend të tretë nga çdo vend anëtar i BE.

Bashkimi Evropian mbështet dhe promovon vlerat Evropiane, pa mohuar identitetin dhe vlerat e secilit shteti anëtar. Veprimtaria e tij bazohet në Traktatet (Traktati i BE-së dhe Traktati i Funkcionimit të BE-së dhe Karta e të Drejtave Themelore) dhe legjisllacionin e hartuar dhe miratuar nga institucionet Evropiane. Standardet e unifikuara Evropiane në të gjitha fushat e veprimit të BE-së përcillen në të gjitha shtetet anëtare nëpërmjet hartimit të Rregulloreve, Direktivave

dhe Vendimeve. Këto akte janë 10 ligje të detyrueshme për shtetet dhe shtetasit e vendeve anëtare të BE-së. Po ashtu, BE ndihmon dhe plotëson kompetencat e shteteve anëtare për arritjen e objektivave për të gjitha fushat e parashikuara në Traktat nëpërmjet rekomandimeve, opinionëve apo financimeve në kuadër të fondeve të ndryshme.

### Vlerat Evropiane:

- **Dinjiteti;**
- **Liria;**
- **Demokracia;**
- **Barazia;**
- **Shteti ligjor;**
- **Të Drejtat e njeriut;**

### Acquis e BE

- **Traktatet**
- **Karta e të drejtave themelore**
- **Rregulloret, Direktivat, Vendimet**
- **Opinionet dhe rekomandimet**
- **Precedenti gjyqësor dhe parimet e përgjithshme**

Veprimtaria politike ekonomike dhe sociale e BE-së menaxhohet dhe drejtohet nga institucionet Evropiane. Këto të fundit e ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke u bazuar në parimet e ekuilibrit dhe bashkëpunimit të sinqertë.

Përbërja dhe kompetencat e tyre reflektojnë balancën e brishtë të ndërqeveritarizmit (interesit kombëtar si prioritar) dhe supranacionalizmit (interesit të përbashkët mbikombëtar).

### Institucionet e BE:

- **Parlamenti**
- **Këshilli Evropian**
- **Këshilli**
- **Komisioni Evropian**
- **Gjykata e Drejtësisë e BE**
- **Banka Qëndrore Evropiane**
- **Agjensi dhe zyra të tjera sipas traktatit**



## Institucionet kryesore politik-bërës në BE janë si më poshtë:

### Parlamenti Evropian.

Parlamenti është institucioni i BE-së i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët Evropianë çdo 5 vjet, me 751 deputetë, ku njëri prej tyre zgjidhet edhe si President i Parlamentit. Tre kompetencat e tij kryesore janë:

- **Miratimi i ligjeve bashkë me Këshillin e BE-së,**
- **Kontrolli politik dhe konsultimi,**
- **Miratimi i buxhetit të BE-së së bashku me Këshillin.**



## Komisioni Evropian.

Komisioni Evropian përbëhet nga një grup komisionerësh (1 komisioner nga çdo vend anëtar) për fushat e politikave të BE-së. Momentalisht ka 28 të tillë dhe njëri prej tyre mban postin e Presidentit të Komisionit. Komisioni Evropian, i themeluar më 1958, është organi ekzekutiv i BE-së. Kompetencat e tij kryesore janë:

- **Propozimi i ligjeve të BE**
- **Promovon interesin e përgjithshëm**
- **Mbikëqyrës i zbatueshmërisë së traktateve dhe të drejtës së BE**
- **Zbaton buxhetin dhe administron programet**
- **Ushtron funksione bashkërenduese, administrative dhe ekzekutuese**
- **Përfaqëson BE në marrëdhëniet jashtë**



## Këshilli i BE-së.

Këshilli i BE-së njihet ndryshe, si Këshilli i Ministrave (apo thjesht Këshilli) dhe përbëhet nga ministrat e çdo vendi të BE-së, duke qenë zëri i qeverive të shteteve anëtare që miraton ligjet dhe koordinon politikat Evropiane. Ndryshe nga institucionet e tjera të BE-së, ai nuk ka një individ si president, por çdo shtet anëtar mban presidencën për 6 muaj me rotacion. Kompetencat e tij kryesore janë:

- **Miraton legjislacionin dhe buxhetin Evropian së bashku me PE**
- **Kryen funksione të politikbërjes dhe bashkërendimit sikurse parashikon Traktati**



## Këshilli Evropian

Këshilli Evropian, ndryshe nga Këshilli i BE-së, mbledhet të paktën 4 herë në vit dhe përbëhet nga përfaqësuesit më të lartë të shteteve anëtare Evropiane (udhëheqësit). Këshilli Evropian drejtohet nga Presidenti i Këshillit dhe në mbledhjet e tij marrin pjesë dhe krerët e institucioneve evropiane. Këshilli Evropian përbën nivelin më të lartë të bashkëpunimit mes shteteve të BE-së dhe ka një president me mandat 5-vjeçar. Ndryshe nga Këshilli, ai nuk mund të miratojë ligje por vendos për prioritetet dhe drejtimin e politikave të unionit.





# BE DHE PUSHTETI VENDOR

## Pjesëmarrja

Bashkimi Evropian është një qeverisje shumë nivelëshe dhe si i tillë ai përfshin shumë aktorë në procesin politikbërës. Pushteti vendor nuk ka një status të veçantë në organizim politik të BE, megjithatë ashtu sikurse dhe parashikojnë Traktatet, BE është kujdesur të përfshijë në mënyrë direkte dhe indirekte pushtetin vendor në procesin e saj politik-bërës. Tashmë janë krijuar mekanizmat dhe strukturat që zëri i pushtetit vendor të arrijë jo vetëm nëpërmjet vendeve anëtare, por edhe drejtpërdrejtë në politike-bërjen e BE. Komunikimi i drejtpërdrejtë i pushtetit vendor me strukturat politike të BE realizohet nëpërmjet Komitetit Evropian të Rajoneve (KiR). KiR është strukturë konsultative por me një rol të qartë në procesin vendimmarrës në BE. (KiR) përbëhet nga 350 anëtarë - përfaqësues të zgjedhur në nivel lokal për një mandat 5-vjeçar. Konkretisht anëtarët e KR të cilët emërohen si përfaqësues rajonal dhe të njësisive vendore me zgjedhje të drejtpërdrejta nga qytetarët



**European Committee  
of the Regions**

e zonave përkatëse, mbliidhen me qëllim për të kontribuar në zhvillimin e legjislationit të Bashkimit Evropian. KiR është i organizuar në Komisione të cilat mbulojnë fusha të ndryshme nga qytetaria, qeverisja, marrëdhëniet me jashtë, e deri tek burimet natyrore, kohezioni territorial apo çështjet sociale dhe të edukimit.

## Komisionet e KiR

- **CIVEX** (Komisioni për qytetarinë, qeverisjen, institucionet dhe marrëdhëniet me jashtë)
- **COTER** (Komisioni për Politikat e kohezionit territorial dhe buxhetit të BE)
- **ECON** (Komisioni për politikat ekonomike)
- **ENVE** (Komisioni për mjedisin dhe ndryshimet klimaterike)
- **NAT** (Komisioni për burimet natyrore)
- **SEDEC** (Komisioni për çështjet sociale edukimin, punësimin kërkimin dhe kulturën)

Që nga hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës, Komiteti i Rajoneve duhet të konsultohet gjatë gjithë procesit legjislativ në fushat e mëposhtme:

- **kohezioni ekonomik dhe social,**
- **rrjetet trans-Evropiane,**
- **shëndetësia, arsimit dhe kultura,**
- **punësimi, politika sociale,**

- mjedisi, trajnimi profesional,
- transporti,
- mbrojtja civile,
- ndryshimi i klimës,
- energjia

## **KiR ndërhyt në disa faza të procesit të miratimit të legjislacionit në BE:**

Gjatë fazës paraprake të procesit legjislativ, Komisioni Evropian lançon nisma ligjore:

- **KiR organizon konsultimin me autoritetet vendore dhe rajonale. Këto takime konsultative mbahen rregullisht me qëllim shpërndarjen e informacionit, prioritetet e BE-së si dhe diskutimin e shqetësimeve me autoritetet e brendshme vendore, organizatat joqeveritare dhe grupet e tjera të interesit.**
- **Bashkëpunon me Komisionin Evropian për vlerësimin e ndikimit të implementimit**

Komisioni Evropian gjatë hartimit të propozimit legjislativ duhet të konsultohet me KiR:

- **KiR bashkëpunon me parlamentet kombëtare dhe rajonale, duke respektuar parimin e subsidiaritetit.**

Propozimi legjislativ diskutohet me institucionet e BE-së: Parlamenti Evropian dhe Këshilli konsultohen me KiR:

- **KiR organizon konsultime me shoqëritë që përfaqësojnë autoritet vendore dhe rajonale**
- **Komisionet e Përbashkëta të KiR përgatisin opinione**
- **Anëtarët e KiR mbledhen në sesion plenar për të votuar dhe për të miratuar opinionin zyrtar të KiR në lidhje me propozimin legjislativ**

Propozimi legjislativ ndryshohet në mënyrë të konsiderueshme nga institucionet e tjera të BE-së:

- **KiR rishikon dhe miraton opinion mbi projekt-aktin e ri legjislativ**

Nëse legjislacioni i miratuar nuk është në përputhje me parimin e subsidiaritetit, Komiteti i Rajoneve ka të drejtën për të ngritur padi në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë

- **KiR monitoron zbatimin e aplikimit në nivel rajonal dhe vendor të legjislacionit të miratuar**

## **KiR dhe Zgjerimi i BE**

Për të nxitur dialogun politik me autoritetet lokale dhe rajonale në vendet e zgjerimit, Komiteti i Rajoneve (KiR) ka krijuar të ashtuquajturat Komisione të Përbashkëta Konsultative (KPK) dhe Grupet e Punës (GP). Janë aktualisht katër Komisione të Përbashkëta Konsultative (KPK) dhe dy Grupe Pune (GP) që operojnë në Komitetin e Rajoneve: KPK mes KiR dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, KPK mes KiR dhe Malit të Zi, KPK mes KiR dhe Islandës, KPK mes

KiR dhe Serbisë Grupi punës për marrëdhëniet me Turqinë dhe Grupi Punues për Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë). Çdo vit, dy takime janë organizuar nga secili prej GP dhe KPK, një në Bruksel dhe një tjetër në një vend partner. Ato përbëjnë një platformë të rëndësishme politike për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira mes anëtarëve të KiR dhe pjesëmarrësve nga vendet e zgjerimit. Hapja e negociatave do të krijojë dhe perspektivën e pjesëmarrjes së pushtetin vendor shqiptar në komisionet e përbashkëta. Këto komisione do të ndihmojnë pushtetin vendor të përgatitet për procesin e 20 anëtarësimit, ato analizojnë ndikimin që ka ky proces në nivel vendor, ato shërbejnë si urë komunikimi e dyfishtë për zhvillimet në vendet që do të anëtarësohen dhe në BE, monitorimin e negociatave në fushat më të ndjeshme për pushtetin vendor.

## **Pushteti vendor dhe zbatimi i acquis së BE**

Legjislacioni Evropian i drejtohet shteteve anëtare dhe për pasojë ai u drejtohet aktorëve dhe subjekteve të ndryshme brenda një shteti. Acquis e BE nuk i drejtohet në mënyrë direkte pushtetit vendor të vendeve anëtare, megjithatë ajo e prek atë në dy drejtime, në funksionin e tij si përfaqësues politik dhe në funksionin e tij si ofrues shërbimesh. Një pjesë e vogël e acquis i drejtohet pushtetit vendor (për shembull rregullat Evropiane të prokurimit publik), pjesa tjetër e prek atë si pasojë e zbatimit të legjislacionit Evropian në nivel kombëtar. Në këtë kuadër është e vështirë të thuash se si ndikon acquis si në drejtim të demokratizimit apo decentralizimit, rishikimit të kompetencave të pushtetit vendor.

Megjithatë tashmë janë të qarta politikat e BE, zbatimi i të cilave kërkon edhe përfshirjen e pushtetit vendor pavarësisht

mënyrës së organizimit të vendeve anëtare. Pushtetin vendor e gjejmë të përfshirë në politikën e mjedisit, çështjet sociale dhe punësimin, zhvillimin ekonomik lokal apo mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Pikërisht në këtë manual ju do të gjeni një përmbledhje të synimit të këtyre politikave, dhe mënyrës sesi ato kërkohen të zbatohen dhe nga vendet në proces anëtarësimi/ integrimi siç është dhe Shqipëria.



**BE-JA  
DHE  
SHQIPËRIA**

## Rrugëtimi

Shqipëria sot gjendet në një momentum shumë të rëndësishëm të procesit të integrimit drejt Bashkimit Evropian. Më datë 17 prill 2018 Komisioni Evropian rekomandoi hapjen e negociatave për anëtarësimin saj në BE. Procesi i integrimit Evropian të Shqipërisë ka nisur me përfshirjen e saj në procesin e Stabilizim Asociimit dhe fillimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në vitin 2003, Marrëveshja (MSA) u nënshkrua në 2006 dhe hyri në fuqi në Prill 2009. Zbatimi i kësaj marrëveshje nënkuptonte një angazhim të plotë të shtetit shqiptar për harmonizimin e legjislacionit shqiptar me acquis-në e BE ë një shumëllojshmëri fushash dhe politikash të BE-së.

## Objektivat e MSA-së

- **Forcimi i demokracisë dhe sundimit të së drejtës;**
- **Stabiliteti politik, ekonomik e institucional;**
- **Kuadër i përshtatshëm për dialog politik;**
- **Zhvillimi i bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar nëpërmjet përafrimit të legjislacionit;**
- **Përfundimi i tranzicionit dhe krijimi i një ekonomie tregu funksionale; zhvillimi gradual i një zone të tregtisë së lirë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.**

Procesi i integrimit është subjekt i kushteve që vendos BE dhe këto kushte kërkojnë angazhim në të gjitha drejtimet. Kushtet e BE-së njihen ndryshe dhe si 3 Kriteret e Kopenhagenit dhe ato përfshijnë atë politik, ekonomik dhe ligjor. Plotësimi i kriterit



politik është çelësi i suksesit 24 për marrjen e statusit të vendit kandidat dhe hapjen e negociatave. Arritjet e evidentuara në përmbushjen e këtij kriteri bënë të mundur marrjen e Statusit kandidat në vitin 2014, ndërkohë që fati i negociatave varet nga përmbushja e të ashtuquajturave prioriteteve kyçe brenda kriterit politik të Kopenhagenit që lidhen me reformën në drejtësi, administratën e pavarur, luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

### 3 Kriteret e Kopenhagenit (1993)

- **Kriteri politik:** stabilitet institucional që garanton demokracinë, respektimin e shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut, dhe mbrojtjes së minoriteteve
- **Kriteri ekonomik:** ekonomi tregu funksionale, e aftë për të përballuar konkurrencën dhe forcën e tregut të BE-së.
- **Kriteri ligjor:** aftësia për të marrë përsipër detyrimet për anëtarësim, duke përfshirë dhe kapacitetin për të zbatuar në mënyrë efektive standardet dhe politikat evropiane që përbëjnë acquis-në e BE-së dhe për të aderuar në qëllimet ekonomike dhe monetare të Bashkimit.

Negociatat do të kenë si bazë të tyre analizimin e procesit të përafrimit dhe të zbatimit të legjislacionit tonë konform standardeve Evropiane. Vetëm BE i ka ndarë legjislacionin në kapituj. Janë 35 kapituj që përmbledh të gjithë legjislacionin Evropian dhe që përcaktojnë detyrimet e anëtarësimit.

## Anëtarësimi në BE në tre hapa:

- **Aplikimi** - Kur vendi është gati, ai bëhet zyrtarisht kandidat për anëtarësim – kjo jo domosdoshmërisht nënkupton hapjen e negociatave;
- **Negocimi** - Përafrim dhe zbatim legjislativi, reformash, përbushja e kushteve për anëtarësim;
- **Anëtarësimi** - Përbushja e negociatave dhe reformave që shoqërojnë procesin.

Fazat e negociatave janë 8, ku përfshihen hapja e negociatave, screening (shqyrtimi), negocimi i çdo kapitulli, mbyllja provizore e kapitujve, konkluzioni i negociatave, nënshkrimi i Traktatit të anëtarësimit, referendum dhe ratifikimi i Traktatit dhe së fundmi hyrja në fuqi e Traktatit/ Anëtarësimi. Gjatë këtyre fazave pushteti vendor luan një rol shumë të rëndësishëm.

## Detyrimet për pushtetin vendor

Pushteti vendor nuk është aktori kryesor i menaxhimit të procesit të integritimit, por detyrimet dhe roli i tij vihen re si para dhe pas procesit të anëtarësimit. Procesit i integritimit të Shqipërisë ndikon direkt dhe indirekt në reformimin e pushtetit vendor si njësi e përfaqësimit, por dhe si ofrues shërbimesh për qytetarët. Demokratizimi dhe decentralizimi i pushtetit vendor është një proces i vazhdueshëm që ndikohet jo vetëm nga Karta Evropiane e vetëqeverisjes vendore të Këshillit të Europës, por edhe nga monitorimi i vazhdueshëm që bën BE. Rekomandimet e dhëna nga Raportet e Komisionit

Evropian mbi Shqipërinë kanë shërbyer si bazë për reformat e marra për pushtetin vendor, si psh, reforma territoriale, apo garantimin e statusit 26 të nëpunësit civil për punonjësit vendorë. Pushteti vendor në Shqipëri ka qenë përfitues i drejtpërdrejtë i ndihmës financiare të BE dhe pjesëmarrës në shumë nisma. Pikërisht këto iniciativa janë edhe në funksion të zbatimit të nenit 110 të MSA ku parashikohet se:

*“Palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale. Kujdes i veçantë do t’i kushtohet bashkëpunimit ndërkuftar, trans-kombëtar dhe inter-rajonat. Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me acquis në fushën e zhvillimit rajonal.”*

Neni 6 dhe 70 i MSA-së parashikojnë detyrimin e Shqipërisë për të përafuar legjislacionin e saj me atë të BE-së në fushat që kanë të bëjnë me tregun dhe çështjet ekonomike në fazën e parë të zbatimit të MSA dhe në fazën e dytë detyrimi shtrihet edhe tek fushat e tjera të acquis. Në rrugëtimin Evropian të Shqipërisë është thelbësore të kuptohet që rreth 70% e legjislacionit të BE-së zbatohet në nivel lokal dhe rajonal, ndaj kuptohet qartë se pushteti vendor ka një rol shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e të gjithë procesit të integritimit. Për këtë arsye, ndërgjegjësimi dhe informimi i njësive lokale për standardet Evropiane është i rëndësishëm.

<b>Roli i pushtetit vendor në Integrimin Evropian</b>	
<b>Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore</b>	
<b>Traktati i Lisbonës</b>	
<b>Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MAS)</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Referim Direkt i NjQV (Neni 110 – Zhvillimi Rajonal dhe Lokal)</li> <li>2. Përafrim i Legjislacionin në fusha të ndryshme të politikave zbatuar nga NjQV</li> </ol>
<b>Raporti i Komisionit Evropian</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Referencë Specifike të qeverisjes lokale</li> <li>2. Referencë e rolit të NjQV-ve në arritjen e procesit të Integritimit Evropian duke u angazhuar në fusha të caktuara të politikave.</li> </ol>
<b>Negociatat për anëtarësim</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. NjQV mund të jenë prezent në diskutimin e disa kapitujve në varësi të kompetencave.</li> </ol>
<b>Sektorët ku përfshihet pushteti vendor</b>	Zhvillimi rajonal dhe kohezioni social, punësimi dhe përfshirja sociale, mbrotja e mjedisit, të drejtat e njeriut, arsimit dhe kultura, transporti dhe energjia, etj

*Në këtë kohë ndryshimesh dhe duke qenë të ndërgjegjshëm për sfidat e qytetarëve tanë, ne angazhohemi në Axhendën e Romës për të punuar drejt një Evrope më sociale, të një bashkimi që bazohet te rritja e qëndrueshme, promovimi i progresit social si edhe kohezionit dhe konvergjencës sociale, duke ruajtur integritetin e tregut të brendshëm, një bashkim që mban në konsideratë diversitetin e shteteve anëtare dhe partnerëve kyç socialë, një bashkim që promovon barazinë midis burrit dhe gruas dhe shanset e barabarta për të gjithë; një bashkim që lufton papunësinë, diskriminimin përjashtimin social dhe varfësinë, një bashkim ku të rinjt marrin edukimin dhe trajnimin me të mirë dhe që mund të studiojnë dhe të gjejnë punë kudo në kontinent; një bashkim që ruan trashëgimninë kulturore dhe që promovon diversitetin kulturor.*

Deklarata e Romës,

**Liderat e BE,**

25 Mars 2017





# FUSHAT PRIORITARE PËR PUSHTETIN VENDOR

Fushat për të cilat pushtetin vendor ka një rol të rëndësishëm në zbatim janë të shumta. Megjithatë me të rëndësishme duke u nisur edhe si nga eksperiencia Evropiane dhe nga kompetencat e pushtetit vendor në Shqipëri, më të rëndësishme mbeten çështjet sociale dhe të punësimit, mbrojtja e të drejtave themelore, zhvillimi ekonomik rajonal dhe mbrojtja e mjedisit. Për këtë arsye me poshtë do të trajtojmë standardet e BE në këto fusha dhe domethënien e tyre për Shqipërinë dhe pushtetin vendor në veçanti.

## Punësimi dhe çështjet sociale në BE

Dimensioni social i BE mbetet një nga sfidat e së tashmes dhe së ardhmes së Bashkimit Evropian.

**Legjislacioni i BE** - Baza ligjore ku mbështetet politika e punësimit dhe përfshirjes sociale janë nenet 45-55 (lëvizja e lirë e punonjësve), nenet 145-164 (punësimi dhe politikat sociale) dhe legjislacionin dytësor (rregullore, direktiva dhe soft law).

Legjislacioni dhe çdo veprim tjetër i ndërmarrë nga BE në këtë fushë, synon krijimin e kushteve për punësim, modernizimin e sigurimeve shoqërore, lëvizjen e lirë të punonjësve, zbutjen e varfërisë, mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara dhe mosdiskriminimin. Për përmbushjen e këtyre synimeve, përgjatë veprimtarisë së saj BE ka hartuar një sërë dokumentesh strategjikë, ligjesh dhe programesh që mundësojnë krijimin e vendeve të punës, dialogun social, mbrojtjen në punë, respektimin e të drejtave dhe gjithëpërfshirjen.

## Direktivat kryesore mbi politikat e punësimit dhe mbrojtjen sociale në BE

- **Direktiva 89/391/EEC e Këshillit, e datës 12 qershor 1989** “Mbi prezantimin e masave për të inkurajuar përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në punë”;
- **Direktiva 2003/88/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 4 nëntor 2003** “Mbi aspekte të caktuara të kohës së punës”;
- **Direktiva 96/71/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 16 dhjetor 1996** “Mbi dërgimin me shërbim të punëtorëve për 32 ofrimin e shërbimeve”;



- Direktiva 2014/36/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 26 shkurt 2014 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimin të shtetasve të vendeve të treta me qëllim punësimin si punonjës sezonalë”;
- Direktiva 2000/78/EC e Këshillit, e datës 27 nëntor 2000 “Mbi përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim”;
- Direktiva 2004/113/EC e Këshillit, e datës 13 dhjetor 2004 “Mbi implementin e parimit të trajtimit të barabartë gjinor në aksesimin dhe përfitimin e të mirave dhe shërbimeve”;
- Direktiva 77/486/EEC e Këshillit, e datës 25 korrik 1977 “Mbi edukimin e fëmijëve të punëtorëve emigrantë”;
- Direktiva 2004/114/EC e Këshillit e 13 dhjetorit 2004 “Mbi kushtet e pranimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim studimi, shkëmbimi studentor, trajnim të pashpërblyer ose shërbim vullnetar”.

**Institucionet e BE:** të gjitha institucionet politikëbërëse dhe konsultative në BE, secila sipas rolit të tyre, janë të përshira në politikën e punësimit dhe mbrojtjes sociale. Pa dyshim që Komisioni Evropian luan një rol të rëndësishëm në këtë fushë. Ndërkohë, ekzistojnë dhe një numër agjensish të cilat i kushtohen ekskluzivisht kësaj fushe, përfshirë edhe:

**Fondi Social Evropian (FSE)** FSE është instrumenti kryesor komunitar për të përkrahur dhe promovuar punësimin. Financimi i FSE-së prej 10 miliardë euro në vit ka përmirësuar perspektivat e punës për miliona Evropianë, veçanërisht ata të cilët hasin vështirësi në gjetjen e punës. Komisioni Evropian dhe shtetet anëtare në partneritet janë ato që përcaktojnë prioritetet e FSE-së dhe mënyrën sesi ajo i shpërndan resurset

(projektet bashkëfinancohen nga BE-ja dhe shtetet anëtare me financim buxhetor ose privat). Prioritetet e tjera kanë në fokus përmirësimin e aksesit në punësim: duke i ndihmuar të rinjtë në kalimin nga shkolla në punë dhe duke trajnuar punëkërkues më pak të kualifikuar për t'i ndihmuar të përmirësojnë perspektivat për punë.

- 
- Agjencinë Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Vendin e Punës (**EU-OSHA**)
  - Qendrën Evropiane për Zhvillimin e Trajnimit Profesional (**CEDEFOP**)
  - Fondacionin Evropian për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës dhe Punës (**Eurofond**)
  - Autoritetin Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve të Punës (**EIOPA**)
  - Fondacionin Evropian të Trajnimit (**ETF**)
- 

## Programet financuese të BE-së

- Fondi Social Evropian (**ESF**)
- Fondi për Përshtatjen e Globalizimit Evropian (**EGF**)
- Fondi për Ndhmën Evropiane për kategoritë e privuara (**FEAD**)
- Programi i BE për Inovacionin Social dhe në Punësim (**EaSI**), i cili përfshin: Progres; Shërbimet Evropiane të Punësimin (**EURES**); Sipërmarrja sociale dhe mikrofinanciare

## Detyrimet për Shqipërinë

### Niveli kombëtar

Detyrimet për Shqipërinë në fushën e punësimit dhe mbrojtjes sociale vijnë përmjet detyrimit për të përafruar legjislacionin shqiptar më atë të parashikuar nga **Kapitulli 19 të acquis-së së BE-së**.

Acquis e BE-së e përfshirë në Kapitullin 19: “Politika Sociale dhe Punësimi”, është pjesë e legjislacionit Evropian e Politikës sociale dhe të Punësimit. Legjislacioni Evropian i këtij kapitulli kërkon që Shqipëria nëpërmjet ndryshimeve të kuadrit ligjor dhe institucional, të garantojë mbrojtjen e së drejtës së punës, kushtet e punës, mundësitë të barabarta, dhe anti - diskriminimit. Pjesë e detyrimeve janë dhe njohja apo pjesëmarrja në dialogun social Evropian për punësimin, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen sociale.

**Legjislacioni:** Legjislacioni i vendit tonë parashikon një sërë parimesh të parashikuara po ashtu edhe nga acquis-ja e BE-së. Legjislacioni ynë në këtë fushë është i përafruar në përgjithësi me standardet e BE, por ky proces nuk mund të konsiderohet i përfunduar plotësisht.

### Legjislacioni kryesor shqiptar mbi punësimin, marrëdhëniet e punës dhe çështjet sociale

- Ligj Nr. “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;
- Ligj Nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligj Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil (i ndryshuar);

- Ligj Nr. 135/2016 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjitike”;
- Vendim KM Nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”;
- Ligjin Nr. 44/2016 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, VKM Nr 425 datë 27.06.2012 e ndryshuar me VKM Nr 839 datë 03.12.2014, “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe private, të përkujdesit shoqëror për PAK”.

**Institucionet:** Në Shqipëri, institucionet kryesore që kanë përgjegjësinë për zbatimin e politikave kombëtare për sa u përket çështjeje të punësimit dhe atyre sociale janë si më poshtë.

- Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP);
- Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH);

### **Programet financuese:**

- Fondi Special i Aksionerëve të BERZH-it për promovimin dhe mbështetjen e bizneseve të drejtuara nga gratë në Shqipëri;
- Fondi i ndihmës ekonomike (NE);
- Fondi i ndihmës për Personat me Aftësi të Kufizuar (PAK).

## Niveli vendor

Përfshirja e pushtetit vendor në politikat sociale dhe të punësimit është mjaft e madhe. Së pari pushteti vendor është punëdhënës dhe për pasojë ai duhet të zbatojë rregullat që kanë të bëjnë më të drejtën e punës dhe mbrojtjen në punë. Tërësia e ligjeve që rregullojnë statusin e punonjësve, të drejtat e tyre, kushtet dhe mosdiskriminimin, zbatohet edhe në nivel lokal.

## Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020

**Objektivi 1:** Mbrojtja sociale në nivel vendor - shtimi i shërbimeve të kujdesit social dhe numri i nëpunësve vendorë që e mbulojnë këtë sektor, ngritja e një sistemi të integruar informacioni në nivel qendror dhe rajonal (Sistem Menaxhimi Informacioni) për shërbimet e kujdesit social. 80% e bashkive të vendit janë trajnuar nga ministria e linjës mbi strategjinë kombëtare për mbrojtjen sociale dhe përgjegjësinë që ajo ngarkon mbi njësitë e pushtetit vendor. Gjithnjë mbi bazën e kërkesave që parashtron Strategjia janë ngritur QMF (Qendra Multifunkionale) në 21% të bashkive të vendit dhe QD (Qendra Ditore) në gati 30% të bashkive, të cilat ofrojnë shërbime sociale për komunitetin rom e egjiptian, fëmijët jetimë e të moshuarit.

**Objektivi 2:** Mbështetja për programet aktive të punës - Për realizimin e këtij objektivi kërkohet bashkëpunimi mes bashkive dhe drejtorive arsimore rajonale për të mundësuar trajnimin dhe zhvillimin e njohurive dhe arsimit profesional

në të gjithë territorin e Shqipërisë. Për zbatimin e bazës së nevojshme ligjore, nevojitet shtimi edhe i kapaciteteve njerëzore që do ta aplikojnë në terren, një synim tjetër ky që theksohet në Strategji.

**Objektivi 3:** Përfshirja sociale në nivel vendor - Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016-2020, matja e elementeve dhe treguesve të ndryshëm e duke i vlerësuar dhe monitoruar ata. Rritja e numrit të bashkive që kanë plane të hartuara për veprimin mbi përfshirjen sociale dhe në të cilat të jetë ngritur edhe baza e të dhënave statistikore me treguesit e BE-së për këtë objektiv specifik.

Ndërkohë që roli i tij në zbatimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e politikave sociale dhe të punësimit mund të përmbledhet si më poshtë:

- **Mbledhjen e të dhënave**
- **Hartimin e planeve për shërbimet sociale dhe për përfshirjen sociale**
- **Ofrimin e shërbimeve sociale**
- **Pjesmarrjen në organizimin e trajnimeve profesionale**

Në çdo rast këto detyra janë ose duhen shoqëruar me rritje kapacitetesh të dedikuara brenda njësisë të qeverisjes vendore.



**Human Rights**

# **MBROJTJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT**

## **Mbrojtja e të drejtave të njeriut në BE**

Dinjiteti njerëzor, liria, demokracia, barazia, sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut, janë vlera të përfshira në traktatet e BE-së. Mbrojtja e të drejtave të njeriut në BE synon:

- Promovimin e të drejtave të grave, fëmijëve, minoriteteve dhe personave vulnerabël

- Ndalimin e dënimit me vdekje, torturës, trafikimit njerëzor dhe diskriminimit
- Mbrojtjen e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore

**Si legjislacion bazë shërben në radhë të parë** Traktati i BE në nenet 2, 3 dhe 6 dhe kryesisht, **Karta e BE-së për të Drejtat Themelore**, e cila është një dokument i qartë dhe i fortë e të drejtave të qytetarëve të BE-së. Mbrojtja e të drejtave themelore është një çështje horizontale, e cila prek të gjitha fushat e veprimtarisë së BE-së. Kjo do të thotë se ato duhet të merren në konsideratë nga të gjitha organet e BE në punën e tyre, pavarësisht nga niveli i tyre ose nga temat që mbulojnë. Kjo e fundit i bën automatikisht të gjithë qytetarët e një vendi të BE-së shtetas të BE-së dhe kjo vjen me disa të drejta dhe përgjegjësi të rëndësishme shtesë. Këto janë të përshkruara në Traktatin për Funkionimin e Bashkimit Evropian (Neni 20) dhe Karta e të Drejtave Themelore (Kapitulli V). Për të rritur ndërgjegjësimin për shtetësinë e BE-së midis autoriteteve publike dhe kombëtare, Komisioni publikon periodikisht një Raport të Shtetësisë së BE-së.

## **Karta e BE-së për të Drejtat Themelore**

Në vitin 1999 Këshilli Evropian propozoi që një “trup i përbërë nga përfaqësues të Kryetarëve të Shteteve dhe Qeverive dhe të Presidentit të Komisionit, si dhe të anëtarëve të Parlamentit Evropian dhe parlamenteve kombëtare” duhet të formohet për të hartuar një kartë themelore të të drejtave. [6] Meqënëse u krijua në dhjetor të atij viti “trupi” u vetëquajt “Konventa Evropiane”. Konventa e miratoi draftin



më 2 tetor 2000 dhe u miratua solemnisht nga Parlamenti Evropian, Këshilli i Ministrave dhe Komisioni Evropian më 7 dhjetor 2000. Në të njëjtën kohë, megjithatë, ajo vendosi të shtyjë marrjen e një vendimi për statusin ligjor të Kartës. Megjithatë, ajo u miratua duke mbajtur gjithnjë me vete peshën politike të miratimit nga tre institucione të fuqishme dhe si e tillë, u citua rregullisht nga GJED-ja si një burim i të drejtave themelore.

## Karta

- përcakton të drejtat themelore që janë të detyrueshme për institucionet dhe organet e BE-së;
- vlen për qeveritë kombëtare kur ata po zbatojnë ligjin e BE-së;
- individët që kërkojnë dëmshpërblim duhet të ezaurojnë instancat gjyqësore në vendin e tyre. Si mjet i fundit, ata mund të aplikojnë në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë (GJED);
- karta është në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e cila është ratifikuar nga të gjitha vendet e BE. Agjencia për të Drejtat Themelore (FRA) identifikon dhe analizon tendencat kryesore në këtë fushë.

Përveç kësaj, ekziston një organ i specializuar që merret me të gjitha çështjet që lidhen drejtpërdrejt me të drejtat themelore: Partia e Punës për të Drejtat Themelore, të Drejtat e Qytetarëve dhe Lëvizja e Lirë e Personave (FREMP). Përmes legjislacionit, synohet të promovohet edhe besimi tek institucionet Evropiane.

## Aktet kryesore në nivel Evropian mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

- Direktiva Nr. 2000/78/EC e Këshillit, e 27 nëntorit 2000 “Për krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion”;
- Rregullorja Nr. 2016/2134 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 23 nëntor 2016 që amendon Rregulloren Nr. 1236/2005 të Këshillit “Mbi tregtinë e mallrave të caktuara të cilat mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturim apo të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese trajtim ose dënim”;
- Në vitin 2008, Komisioni Evropian paraqiti një propozim për një Direktivë të Këshillit “Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë jashtë tregut të punës, pavarësisht nga mosha, aftësia e kufizuar, orientimi seksual ose besimi fetar”, i cili synon të zgjerojë mbrojtjen nga diskriminimi nëpërmjet një qasje horizontale. Direktiva po has pengesa nga vendet anëtare por Komisioni vazhdon ta ketë prioritet.

## Agjencitë e specializuara në nivel BE-je për të drejtat e njeriut janë:

Më 26 shkurt 2018, Këshilli miratoi konkluzione mbi prioritetet e BE në forumin e të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara në 2018. Në këtë vit duke shënuar 700 vjetorin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, konkluzionet nënvizojnë se BE e mbështet fuqishëm premtimin nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së për të rritur profilin e të drejtave të njeriut dhe për të bërë parandalimin dhe paqen e qëndrueshme si prioritet i sistemit të OKB-së, duke trajtuar shkaqet rrënjësore të konflikteve, duke

përfshirë trajtimin e shkeljeve dhe abuzimeve të të drejtave të njeriut. BE gjithashtu përsërit qëndrimin e saj të fortë se të gjitha të drejtat e njeriut janë universale, të pandashme, të ndërvarura dhe të ndërlidhura.

- Agjensia e BE-së për të drejtat themelore;
- Supervisorin Evropian për mbrojtjen e të dhënave; 42
- EUROPOL;
- EUROJUST.

## Programet kryesore financuese në nivel komunitar janë:

- Instrumenti Kontribuues për Stabilitetin dhe Paqen (IcSP);
- Fondi Evropian i Zhvillimit (EDF);
- Instrumenti i Bashkëpunimit për Zhvillim (DCI);
- Instrumenti për Bashkëpunimin për Sigurinë Bërthamore (INSC).

## Detyrimet në kuadër të drejtave të njeriut për Shqipërinë

### Niveli kombëtar

Detyrimi i Shqipërisë në kuadër të procesit të anëtarësimit për të drejtat e njeriut, buron nga legjislacioni i përfshirë në kapitullin 23 të acquis-së që kërkon respektimin e të drejtave themelore dhe të drejtave që rrjedhin nga Qytetaria Evropiane.

Ndërkohë, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri njihet si legjislacion bazë vetë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila i dedikon çështjes gjithë pjesën e saj të dytë nën emrin “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”. Po ashtu, në nenin 17 të saj, Kushtetuta jonë vendos në të njëjtin status ligjor me të edhe KEDNJ-në si standard dysHEME për respektimin e të drejtave të njeriut kur thekson se:

- “1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.”, dhe se
- “2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. “

## Legjislacioni shqiptar mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

- Kushtetuta;
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
- Strategjia për mbrojtjen e fëmijëve;
- Ligji nr. 18/2017 “Për Mbrojtjen e Fëmijëve”;
- Ligji nr. 37/2017 “Kodi Penal për të Mitur”;
- Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar 2016– 2020;
- Plani Kombëtar i veprimit “Për personat LGBT” 2016–2020;

- Plani Kombëtar i veprimit “Për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve” 2016–2020;
- Axhenda Kombëtare “Për të Drejtat e Fëmijëve” 2017–2020;
- Ligji 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

## **Institucionet kyçe në nivel kombëtar për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut janë:**

- Avokati i Popullit;
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Shërbimi Social Shtetëror;
- Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.
- Sistemi gjyqësor deri tek Gjykata Kushtetuese

### **Niveli lokal**

Pushteti vendor përfshihet në çështjet e mbrojtjeve të drejtave të njeriut, pasi ai vetë duhet t’i respektojë ato në raport me qytetarët dhe të gjitha subjektet që ndërveprojnë me të, sikurse dhe duhet të kontribuojë që të drejtat e njeriut të kenë një garantim më të mirë në Shqipëri. Duke u nisur nga problematika që kanë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në nivel vendor. Për këtë arsye vihet re

ristrukturimi i njësive me qëllim ngritjen e njësive që kujdesen për të drejtat e fëmijëve, barazinë gjinore, diskriminimin dhe gjithë përfshirjen. Ndërkohë vetë autoritet qendrore kërkojnë rrisin prezencën e tyre në nivel lokal siç është rasti i Avokatit të Popullit apo Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

## - MBI TË DREJTAT E TË MITURVE -

*“Bazuar në Ligjin nr. 10347, dt. 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, ASHMDF është përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të këtij ligji. Neni 3 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 266, dt. 12.04.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, përcakton se ASHMDF (Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve) bashkëpunon me Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) në nivel bashkie/komune për të garantuar zbatimin e legjislacionit dhe politikave shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet monitorimit të zbatimit të detyrave të këtyre strukturave të përcaktuara në Nenin 39 të Ligjit nr. 10347, dt. 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”. Vetë NJMF-të kanë nënvizuar se ASHMDF duhet të luajë një rol më të madh si institucion që mbron, nxit dhe ushtron ndikim në nivel qendror dhe vendor lidhur me rolin dhe punën e NJMF-ësë, dhe për caktimin e një fondi të veçantë për NJMF-të me qëllim trajtimin dhe mbështetjen e rasteve emergjente. Gjithashtu, aktorët vendorë të angazhuar për mbrojtjen e fëmijës presin nga ASHMDF mbështetje teknike dhe të specializuar për çështje të vështira dhe bashkërendimin e punës për mbrojtjen e fëmijës në bashkitë vendore.”*

- Shkëputur nga **“E ardhmja e sistemit të integruar për mbrojtjen e fëmijës në Shqipëri”**, dokument mbi politikat përgatitur nga  
zj. Anniki Lai, eksperte në Këshillin e Evropës -



# POLITIKA MJEDISORE

## Politika mjedisore e BE-së

Politika mjedisore e BE-së synon të eliminojë, zbusë dhe të parandalojë ndotjen, për të siguruar përdorimin e burimeve natyrore, me qëllim:

- Nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm;
- Parandalimin e dëmtimit të mjedisit; si dhe
- Sigurimin e integritit të çështjeje mjedisore në politikat e tjera sektoriale (të tilla si energjia, transporti, etj.).



“Në vitin 2050 do të jetojmë mirë, brenda kufjve ekologjikë të planetit. Prosperiteti dhe ambienti ynë i shëndetshëm rrjedhin nga një ekonomi inovative dhe rrethuese, ku asgjë nuk shpërdorohet dhe ku burimet natyrore menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme dhe biodiversiteti mbrohet, vlerësohet dhe restaurohet në mënyra që rrisin qëndrueshmëria e shoqërisë sonë. Rritja jonë e ulët e karbonit është zhvendosur prej përdorimit të resurseve, duke vendosur ritmin për një shoqëri globale të sigurt dhe të qëndrueshme”.

-Programi i 7-të i BE-së për Veprimin Mjedisor -

**Legjislacioni:** Zhvillimi i qëndrueshëm është një objektivat e Bashkimit për të cilën ai është zotuar të garantojë një mbrojtje të madhe të mjedisit (neni 3 TBE). Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, mjedisi u bë një zonë e kompetencave të përbashkëta mes shteteve anëtare dhe BE-së (nenet 11, 191-193 të TFBE). Legjislacioni në fushën e mjedisit është i përbërë nga akte të tjera legjislative si rregulloret apo direktivat të cilat synojnë mbrojtjen e natyrës, ajrit, ujit menaxhimin e plehrave, rritjen e njohurive rreth toksinave kimike, dhe ndihmojnë biznesin drejt një ekonomie të qëndrueshme.

Në lidhje më ndryshimet klimaterike, BE formulon dhe zbaton politika dhe strategji duke luajtur një rol lider në negociatat ndërkombëtare. BE është e angazhuar për të zbatuar marrëveshjen e Parisit dhe sistemin Evropian të transmetimit të gazit (EU ETS). Çështjet e mjedisit mbahen në vëmendje edhe kur diskutohen politika të tjera sikurse është energjia apo transporti dhe BE promovon teknologjinë e pastër. Vendet anëtare kanë detyrime 48 strikte të raportojnë në BE për mbrojtjen e mjedisit. Deri më tani BE ka zbatuar 6 Programe Mjedisore Veprimi. Më i fundit është Programi i 2014-ës, i cili i orienton politikat Evropiane mjedisore deri në vitin 2020.

Objektivat e këtij programi janë si më poshtë:

1. mbrojtja dhe zhvillimi i pasurisë natyrore të BE-së;
2. shndërrimi i BE-së në një ekonomi eficiente, të gjelbër dhe konkurruese që konsumon sa më pak karbon; dhe
3. mbrojtja e qytetarëve të BE-së nga rreziqet mjedisore që mund t'u rrezikojnë shëndetin dhe mirëqenien.

## Direktivat kryesore mbi mjedisin në De

- Direktiva 2004/35/EC , datë 21.04.2004 “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi mjedisin”, amenduar.
- Direktiva 2001/42/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 27.06.2001 “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara.”;
- Direktiva 2011/92/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13.12.2011 “Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private”, amenduar.
- Direktiva 2003/35/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26.05.2003 “Mbi tërheqjen e publikut në vendimmarrje në hartimin e planeve e programeve në fushën e mjedisit dhe amendimet për pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin në drejtësi të Direktivave të Këshillit 85/337/EEC dhe 96/61/EC”;
- Direktiva 2003/4/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së, datë 28.01.2003 “Mbi të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 90/313/EEC”;
- Vendimi i Këshillit të BE-së 2005/370/EC, datë 17.02.2005 “Për miratimin në emër të Komunitetit Evropian të Konventës ‘Për të

drejtën për informim, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatave për çështjet mjedisore' ”.

- Direktiva raportuese: Direktiva 91/692/EEC e Këshillit, datë 23 dhjetor 1991 “Mbi standardizimin dhe racionalizimin e raporteve mbi implementimin e Direktivave të caktuara lidhur me fushën mjedisore”; Direktiva 85/337/EEC e 27 Qershorit 1985 “Mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve të caktuara publike dhe private”, amenduar nga Direktiva 97/11/ EC e Këshillit, e datës 3 Mars 1997.
- Direktiva 2010/75/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 24 nëntor 2010 “Mbi mbetjet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes).”

Mes agjencie kryesore Evropiane përgjegjëse për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave komunitare mjedisore, përmendim:

- Agjencia Evropiane e Kimikateve (ECHA);
- Agjencia Evropiane e Mjedisit (EEA).

Ndërkohë, disa organizata të tjera janë edhe:

- Sipërmarrja e Përbashkët “Qielet dhe Pastër”;
- Sipërmarrja e Përbashkët e Qelizave të Karburantit dhe Hidrogjenit.

## Programet kryesore financuese të BE-së për mjedisin janë si më poshtë:

- LIFE: instrumenti financiar i BE-së që mbështet projektet e 50 mjedisit, ruajtjen e natyrës dhe veprimet klimatike në të gjithë BE-në. Që nga viti 1992, LIFE ka bashkëfinancuar më shumë se 4500 projekte. Për periudhën 2014-2020 të financimit, LIFE do të kontribuojë rreth 3.4 miliardë euro për mbrojtjen e mjedisit dhe klimës;
- Fondi i Financimit të Kapitalit Natyror (NCF): një instrument i ri financiar i cili do të ofrojë mundësi financimi në formën e huave apo investimeve të kapitalit për projektet pilot të gjenerimit të të ardhurave ose të kursimit të shpenzimeve që promovojnë ruajtjen e kapitalit natyror, duke përfshirë projektet e adaptimit të ndryshimeve klimatike;
- Financat Private për Instrumentet e Efiçencës së Energjisë (PF4EE): një instrument i ri financiar i cili do të sigurojë hua për investime në projekte të efikasitetit të energjisë të prioritetuara nga Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë.

### **Çfarë progresi është bërë drejt një ekonomie efikase mjedisore?**

- Emetimet evropiane të gazeve serrë kanë rënë me 19% që nga viti 1990, pavarësisht rritjes prej 45% të prodhimit ekonomik, ndonëse nevojiten më shumë reduktime për të arritur një ekonomi me karbon të ulët.
- Në Evropë, sot pyjet mbulojnë rreth 35% të sipërfaqes së tokës (190 milionë ha), duke e bërë Evropën një nga rajonet më të pasura me pyje në botë.

- Kohët e fundit, përdorimi i përgjithshëm i burimeve të BEsë ka rënë me 19% që nga viti 2007. Më pak mbeturina janë duke u prodhuar dhe normat e riciklimit janë përmirësuar në pothuajse çdo vend, megjithëse Evropa mbetet larg idealit të një ekonomie rrethore, ku asgjë nuk shpërdorohet.

## Detyrimet në kuadër të politikave mjedisore për Shqipërinë

### Niveli kombëtar

Detyrimet për Shqipërinë për sa i përket politikës së mjedisit vijnë nëpërmjet detyrimit për të përafuar legjislacionin e Kapitullit 27 të acquis së BE. Rreth 200 akte legjislative të kësaj fushe mbulojnë çështjet horizontale, cilësinë e ajrit dhe të ujit, mbrojtjen e natyrës, menaxhimin e mbetjeve, ndotjen industriale dhe menaxhimin e rrezikut, kimikatet dhe OMGJ, ndotjen akustike dhe pyjet. Përmbushja e standardeve në këtë fushë kërkon investime të mëdha dhe administratë të fortë dhe të pajisur mirë si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal.

### Legjislacioni:

#### Legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri

- Ligj Nr.10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”;
- Ligj Nr.10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”;

- Ligj Nr. 10440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”;
- Ligj Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedor”;
- Ligj Nr. 81 i datës 04.05.2017 “Për Zonat e Mbrojtura”
- Ligj Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
- Ligji 9774/2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”

Vetë Kushtetuta e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit si një nga objektivat 52 kryesorë të Shtetit. Kështu, Neni 59, pika (d) dhe (dh) i Kushtetutës, ndër të tjera, thekson:

*“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:*

- d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;*
- dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm”.*

Ndërkohë, në nenin 56 theksohet: “Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij”.

Legjisllacioni që ka në fokus mjedisin mund të ndahet në Ligj Kuadër dhe Ligje Specifike bazuar në sektorë të ndryshëm, si: procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe vlerësimit strategjik mjedor, cilësia e ujit dhe e ajrit, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja e natyrës, kontrolli i ndotjes industriale,

kimikatet, ndryshimet klimatike, Organizmat e Modifikuara Gjenetiki (OMGJ) etj.

**Institucionet:** në Republikën e Shqipërisë, institucionet kryesore përgjegjëse për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikës kombëtare mjedisore në përputhje me atë komunitare janë:

- **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;**
- **Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM);**
- **Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB);**
- **Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve (ISHMP);**
- **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM);**
- **Drejtoritë Rajonale të Mjedisit.**

**Programet kryesore** financuese për mbrojtjen e mjedisit në vend janë:

- **Fondi Pyjor Publik;**
- **Fondi Kullësor Publik.**

## Niveli lokal

Prioritetet që prekin direkt punën e Njësive të Qeverisjes Vendore, janë: krijimi i qyteteve sa më të qëndrueshme dhe adresimi i sfidave mjedisore ndërkombëtare, përfshirë ato që lidhen me ndryshimet klimatike, në mënyrë sa më efektive.

Ligji 9774/2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” ngarkon bashkitë me përgjegjësinë për hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për zhurmën; drejtimin e procesit të hartëzimit të zhurmës; shpalljen e zonave të qeta, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe vendosjen e kufizimeve të tjera për zhurmën, në përputhje me planin vendor të veprimit.

### **Draft-Strategjinë Ndër-sektoriale të Mjedisit 2015-2020,**

**Objektivi 1:** ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të qeverive vendore për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe administrimit të pyjeve

**Objektivi 2:** hartimi i planeve të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit në nivel vendor.

**Objektivi 3:** përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve

Në Shqipëri ashtu si edhe në pjesën më të madhe të shteteve anëtare, shërbime si trajtimi i ujërave të ndotura, shërbimi dhe sigurimi me ujë të pijshëm, sikundër dhe menaxhimi i mbetjeve janë funksione të drejtpërdrejta të qeverisjes vendore, të cilësuara si prioritare.

Dokumentet e ndryshëm strategjikë vendosin për sa i përket rolit të pushtetit vendor në politikën e mjedisit e vendosin theksin tek:

- **Ndërgjegjësimi dhe rritjes së kapacitete të pushtetit vendor për çështjet mjedisore;**
- **hartimin e planeve lokale për këto çështje**





# POLITIKAT E KOHEZIONIT

## Politikat e Kohezionit të BE-së

Politika rajonale e Bashkimit Evropian njihet edhe me emrin “politikë kohezioni” dhe ka për qëllim përmirësimin e mirëqenies ekonomike të rajoneve në BE-së dhe gjithashtu, shmangien e pabarazive rajonale. Më shumë se një e treta e buxhetit të BE i kushtohet kësaj politike. Si shprehje e solidaritetit ndërmjet Shteteve Anëtare të BE-së dhe rajoneve të tyre, kohezioni ekonomik dhe social synon të arrijë një zhvillim të balancuar socio-ekonomik në të gjithë BE-në. Kjo do të thotë që burimet dhe mundësitë duhet të shpërndahen në mënyrë të barabartë midis rajoneve dhe popullatave të tyre.

## Arritje të politikës rajonale të ndjekur deri tani në BE:

- Të ardhurat janë rritur në rajonet më të varfëra të BE-së me PBB për frymë në rritje në këto zona nga 60.5% të mesatares së BE-së në vitin 2007 në 62.7% në vitin 2010.
- Në periudhën nga viti 2007 deri në vitin 2014 u krijuan 1.3 milion vende të reja pune në BE.
- Deri në vitin 2013 u përkrahën rreth 141 145 start-upe (nisma biznesi)

**Legjislacioni:** politikat rajonale të BE sanksionohen në Nenet 174 – 178 të TFBE: “Kohezioni ekonomik, social dhe territorial”. Qëllimi i këtyre politikave është reduktimi i pabarazisë ekonomike, sociale dhe territoriale midis rajoneve të BE duke ndihmuar në krijimin e vendeve të punës, konkurrencës, rritjes ekonomike, rritjes së cilësisë së jetës dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Në periudhën mes 2014 dhe 2020, BE po investon 325 miliarde EUR për rritjen ekonomike dhe punësimin, si dhe adresimin e ndryshimeve klimatike, energjinë dhe përgjashtimin social.

## Rregulloret kryesore të BE mbi Politiken Rajonale/Kohezionin Social

- Rregullore Nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013 që përcakton dispozitat e përbashkëta 56 për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, Fondin Social Evropian, Fondin e Kohezionit, Fondin Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural dhe atë Evropian Fondit të Zhvillimit Rajonal, Fondit Social Evropian, Fondit të Kohezionit dhe Fondit Evropian të Detarisë

dhe Peshkimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1083/2006, amenduar;

- Rregullore Nr. 1304/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013 mbi Fondin Social Evropian dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1081/2006
- Rregullore Nr. 1301/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013 mbi Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal dhe dispozitat specifike në lidhje me Investimin për Rritje dhe Qëllim të Punës dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) Nr. 1080/2006;
- Rregullore Nr. 1305/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 17 dhjetor 2013 mbi mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural (EAFRD) dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1698/2005;
- Rregullore Nr. 508/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 maj 2014 mbi Fondin Evropian Detar dhe i Peshkimit dhe shfuqizimin e Rregulloreve të Këshillit (EC) Nr. 2328/2003, (EC) Nr 861/2006, (KE) Nr. 1198/2006 dhe (KE) Nr 791/2007 dhe Rregullorja (EU) Nr 1255/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit.

**Institucionet përgjegjëse:** Të gjitha këto fonde manaxhohen nga vetë vendet anëtare të BE-së, përmes marrëveshjeve të partneritetit me Komisionin Evropian. Çdo vend anëtar përgatit një marrëveshje në bashkëpunim me Komisionin, në të cilën përcaktohet sesi do të përdoren fondet gjatë periudhës 2014-2020. Kjo kërkon si parashikime strukturore, ashtu edhe organizative dhe procedurale, pra në total, rregullime të përgjithshme në qeverisjen e secilit shteti anëtar që përfiton nga fondet në fjalë për kohezionin social. Për ta realizuar këtë me sukses, nevojiten më specifikisht:

- a) struktura të posaçme;
- b) burime njerëzore;
- c) mjete dhe sisteme; dhe
- d) mirëqeverisje totale në kuadër të transparencës në vendimmarrje dhe mbajtjen e përgjegjësisë në performancë.

Programet kryesore financuese të BE-së për kohezionin ekonomik, social dhe territorial përfshihen nën emrin e 'Fondeve Evropiane Strukturore dhe të Investimit (ESIF) dhe në të bëjnë pjesë 5 kategori kryesore:

- Fondi Social Evropian (ESF);
- Fondi Evropian për Zhvillimin Rajonal (ERDF);
- Fondi Agrikulturor Evropian
- për Zhvillimin Rural (EAFRD);
- Fondi Evropian Detar dhe i Peshkimit (EMFF);
- Fondi i Kohezionit (CF).

## Fondi i Kohezionit

- U rezervohet shteteve Anëtare, në të cilat të Ardhurat Kombëtare Bruto për banor janë më pak se 90% e mesatares së BE-së. Ai synon të zvogëlojë pabarazitë ekonomike dhe sociale dhe të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm.
- Për periudhën 2014–2020, Fondi i Kohezionit ka për subjekt Bullgarinë, Kroacinë, Qipron, Republikën Çeke, Estoninë, 58 Greqinë, Hungarinë, Letoninë, Lituaninë, Maltën, Poloninë, Portugalinë, Rumaninë, Sllovakinë dhe Slloveninë.

- Fondi i Kohezionit alokon gjithsej 63.4 miliardë euro për aktivitetet në kategoritë e mëposhtme:
- rrytetet trans-evropiane të transportit, sidomos projektet prioritare me interes evropian të identifikuar nga BE;
- mjedisi: në këtë kuadër, Fondi i Kohezionit mund të mbështesë gjithashtu projekte që lidhen me energjinë ose transportin, përderisa ato janë qartësisht në të mirë të mjedisit për nga eficaenca e energjisë, përdorimi i energjisë së rinovueshme, zhvillimi i transportit hekurudhor etj.

Ndihma financiare e Fondit të Kohezionit mund të pezullohet me vendim të Këshillit (të marra me shumicë të cilësuar) nëse një Shtet Anëtar tregon deficit të tepruar publik dhe nëse nuk e ka zgjidhur situatën ose nuk ka marrë masat e duhura për këtë.

Ndërkohë, për periudhën në vijim 2014-2020, politika e kohezionit ka shtruar 11 objektiva kryesorë lidhur me rritjen. Kështu, synohet që përmes saj, BE:

1. Të forcojë kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe inovacionin;
2. Të rritë qasjen/aksesin, përdorimin dhe cilësinë e teknologjive të informacionit dhe komunikimit;
3. Të rritë konkurrueshmërinë e NVM-ve (Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme);
4. Të mbështetë kalimin drejt një ekonomie me konsum të ulët karboni;
5. Të promovojë adaptimin e ndryshimeve klimatike, të parandalojë dhe të manaxhojë rrezikun;
6. Të ruajë dhe mbrojë mjedisin dhe të promovojë efikasitetin e resurseve;

7. Të promovojë transportin e qëndrueshëm dhe të përmirësojë infrastrukturën e rrjetit;
8. Të promovojë punësimin e qëndrueshëm dhe cilësor dhe të mbështetë mobilitetin e punës;
9. Të promovojë përfshirjen sociale, të luftojë varfërinë dhe çdo diskriminim;
10. Të investojë në arsim, trajnim dhe mësim gjatë gjithë jetës; dhe
11. Të përmirësojë efikasitetin e administratës publike.

## **Detyrimet në kuadër të politikave të kohezonit për Shqipërinë**

Detyrimi i Shqipërisë në kuadër të procesit të anëtarësimit buron nga legjislacioni i përfshirë në kapitullin 22 të acquis-së së BE. Në bazë të këtij legjislacioni vendi ynë duhet të garantojë kapacitetet administrative të afta për të hartuar dhe menaxhuar projektet zhvillimore në këtë fushë. Kjo është një nga fushat ku ndërveprimi pushtet qendror dhe vendor është edhe më i domosdoshëm.

Detyrimi i Shqipërisë në kuadër të procesit të anëtarësimit



buron nga legjislacioni i përfshirë në kapitullin 22 të acquis-së së BE. Në bazë të këtij legjislacioni vendi ynë duhet të garantojë kapacitetet administrative të afta për të hartuar dhe menaxhuar projektet zhvillimore në këtë fushë. Kjo është një nga fushat ku ndërveprimi pushtet qendror dhe vendor është edhe më i domosdoshëm.

### Niveli kombëtar

Detyrimet e Shqipërisë për këtë fushë janë kryesisht të natyrës programuese dhe menaxhuese. Në nivel legjislativ nuk është se në këtë fushë ka ligje të mirëfillta. Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim dhe strategjitë sektoriale që e shoqërojnë atë janë dokumente bazë të programimit. Ndërkohë që ato shoqërohen me akte të tjera të parashikimit buxhetor.

Në nivel institucional, të rëndësishme mbeten strukturat e planifikimit dhe e menaxhimit të fondeve të BE.

### Në nivel planifikimi mund të evidentojmë:

- Grupi pilot i menaxhimit të integruar ( Këshilli i Ministrave)
- Drejtoria e fondeve të BE ( Ministria për Europën dhe Punët me Jashtë)

### Në nivel menaxhimi:

- CFCU ( Ministria e Financës, Ekonomisë dhe punësimit)

## Niveli lokal

Duhet theksuar se procesi i anëtarësimit në BE ofron mundësitë për autoritet lokale që të kenë dhe të forcojnë me tej rolin e tyre në zhvillimin lokal dhe rajonal, por kjo nuk do të ndodhë automatikisht. BE mbështet vendet si Shqipëria për zbatimin e politikave të Kohezionit, më specifikisht me Fondin Evropian për Zhvillimin Rajonal dhe Fondin e Kohezionit. Me Skemën e IPA II 2014-2020 e cila nuk kufizon apo limiton pjesëmarrjen dhe qasjen për financime, shteti kandidat mund të përfitojë. Dy nga fushat e politikave të IPA II 2014-2020 janë : Fusha 2 - Zhvillimi Socio-ekonomik dhe Rajonal dhe Fusha 5- Bashkëpunimi Rajonal dhe Territorial, për të cilat Shqipëria po merr dhe do të marrë në vitet në vazhdim mbështetje dhe asistencë.

## 2014 – 2020

Në kuadër të mekanizmit IPA II, gjatë viteve 2014-2020 Shqipëria do të përfitojë nga BE-ja gjithsej rreth 640 milion € asistencë. Në gusht të vitit 2014 u miratua nga Komisioni Evropian Strategjia Kombëtare 2014-2020 për Shqipërinë, e hartuar nëbashkëpunim me qeverinë shqiptare dhe e konsultuar me palët e interesuara. IPA II do të trajtojë çështje themelore në fushën e sundimit të ligjit, demokracisë, qeverisjes ekonomike dhe financat publike, për të mbështetur reformat e suksesshme dhe investimet e nevojshme për procesin e integritimit. Ministria e Integritimit Evropian është koordinatori kombëtar i programeve të asistencës komunitare në Shqipëri. Në këtë fazë programet nuk quhen më Programe komunitare (Community Programmes) por janë emëruar si Programet e Unionit (Union Programmes).



## Disa nga programet e Unionit për 2014-2020 ku Shqipëria merr pjesë janë:

**Horizon 2020:** 'Horizon 2020' është program i ri, i cili ofron një gamë të gjerë mundësish si për studiuesit e BE-së dhe ata shqiptarë, me synim nxitjen e bashkëpunimit midis aktorëve më të mirë ndërkombëtarë. Pjesëmarrja e Shqipërisë në 'Horizon 2020' do të ndihmojë vendin në forcimin e infrastrukturës shkencore, cilësinë e hulumtimit dhe nxitjen e inovacionin, duke kontribuar kështu në integrimin e mëtejshëm të vendit në Hapësirën Evropiane të Kërkimit;

**COSME:** Programi 'COSME' synon nxitjen e konkurrencës midis ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ndërhyrjet mbështesin grupe të veçanta, të cilat mund të kenë vështirësi në arritjen e potencialit të tyre të plotë, si p.sh. të rinjtë, gratë dhe sipërmarrësit e moshuar; Programi për 'Punësimin dhe Inovacionin Social':

**Programi për 'Punësim dhe Inovacion Social':** mbështet nismat dhe strategjitë e qeverive për modernizimin e tregjeve të punës, sistemit të sigurimeve shoqërore dhe rritjen e normave të punësimit, në mënyrë të veçantë midis të rinjve. Pjesëmarrja e Shqipërisë në projektet e BE-së ka për qëllim zvogëlimin e papunësisë në mesin e të rinjve dhe nxitjen e krijimit të e vendeve të reja të punës, duke siguruar financim për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i programit është rritja e inovacionit social në mbarë vendin dhe përmirësimi i aftësive të fuqisë së re punëtore shqiptare.







REPUBLIKA E ALBANI  
MINISTRIA PËR EUROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME



REPUBLIKA E ALBANI  
MINISTRIA E BRENDSHME



Agjencia për Mbrojtjeten e Vetëqeveritjes Vendore

